



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 05
Prishtinë, më 26. 03. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje ishin të pranishëm: Zylfije Hundozi, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova, ndërsa munguan Lutfi Haziri, Džezair Murati dhe Branislav Grbić.

Në mbledhje morën pjesë me ftesë: ministri i Tregtisë dhe Industrisë - Lutfi Zharku dhe sekretari i përhershëm - Ibrahim Krasniqi.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Floreta Kabashi - Agjencioni për Integritet Evropian
Fitore Zeneli - KDI
Lejla Selimi - OSCE
Agron Demi - GAP
Dren Selimi - GAP
Arben Kelmendi- NDT

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Raportimi i ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë për politikën dhe strategjinë e kësaj Ministrie lidhur me integritet evropian,**
- 4. Miratimi i planit të punës,**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë për politikën dhe strategjinë e kësaj Ministrie lidhur me integrimet evropiane

Zylfije Hundozi – njoftoi Komisionin se sipas ftesës në mbledhje është i pranishëm Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, që të na njoftoj për politikën dhe strategjinë e kësaj Ministrie.

Lutfi Zharku - tha se Ministria gjatë vitit 2007, në aspektin e procesit të integrimit evropian është fokusuar në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me vendet fqinje, në Kartën e Ndërmarrjeve të Vogla, në nxitjen e eksportit, në përmbushjen e detyrave që dalin nga dokumenti për Partneritet Evropian për Kosovën dhe në raportimin e rregullt në takimet e Mekanizmit Përcjellës për Asociim Stabilizim (MPAS). Si prioritete për vitin 2008 - tha kemi paraparë: Aprovimin e Kornizës horizontale legjislative, zbatimin e strategjisë afatmesme për zhvillimin e NVM-ve, vazhdimin e përafrimit me direktivat e qasjes së re dhe globale, si dhe me direktivat e qasjes së vjetër, adoptimin e standardeve të mbetura evropiane dhe themelimin e strukturës për mbikëqyrjen e tregut. Zyra për Integritet Evropian në kuadër të MTI-së, ka përcaktuar prioritetet e BE-së, se për implementimin e tyre është përgjegjëse MTI-a, që e ka bërë draftin e Planit të veprimit për partneritet evropian, organizimin e trajnimeve me TAIEX-in, organizimin e workshopit mbi tregun e brendshëm, organizimin e workshopit të inovacionit dhe i ka formuar gjashtë grupe pune. Sa i përket CEFT-ës javën e ardhshme, tha, do të raportojmë për shkëmbimet tregtare të Kosovës për vitin 2007. Për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë do të ishte mirë që së pari ta kemi sistemin tonë të barrierave tarifore ose sistemin unik doganor, sepse sipas një rregulli në momentin kur kërkohet anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë nuk ekziston mundësia e rritjes së tarifave doganore. Për çështje më të hollësishme sa i përket Zyrës për Integritet Evropian ia dha fjalën sekretarit, Ibrahim Krasniqi.

Ibrahim Krasniqi - tha se për implikimet që ka pasur nënshkrimi i marrëveshjes së CEFT-ës, së shpejti do t'u paraqitet raport Komisionit dhe publikut. Ai shpjegoi se Kosova në kohën kur është nënshkruar Marrëveshja e CEFT-ës është paraqitur si UNMIK, ndërsa tani është politikë e Ministrisë që dalëngadalë t'i bartë kompetencat nga ish-Përfaqësuesi Special te vendorët. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë, tha se është sugjeruar që t'i shfrytëzojmë përvojat e Shqipërisë. Për këtë arsye, javën e kaluar, tha, kemi mbajtur një takim në Tiranë në nivel sekretarësh. Si çështje më të rëndësishme për Ministrinë tonë janë: çështja e standardizimit, e akreditimit, mbikëqyrja e tregut, mbrojtja e konsumatorit, çështja e doganave dhe zyra e pronësisë intelektuale, si sektorë të vendosur brenda MTI-së. Ai

shtoi se Agjencioni për Standardizim dhe Akreditim ka krijuar një trup brenda Ministrisë dhe ka marrëveshje duke filluar nga Shqipëria, Italia, Gjermania e vende të tjera që në një të ardhme të afërt edhe Agjencioni për Standardizim dhe Akreditim të ketë mundësi anëtarësimi qoftë në Organizatën Evropiane të Standardeve, qoftë në Organizatën Botërore të Standardeve.

Naser Rugova - kërkoi të procedohet sa më shpejt Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve si një ligj bazik dhe të fillojë jetësimi i Ligjit për akreditim. Sa i përket CEFT-ës, si mekanizëm, tha se nuk ka vetëm përparësi, por duhet të zgjidhen shumë aspekte të tjera dhe të barten kompetencat të Qeveria e Kosovës. Ai shpjegoi se të mbrojtja e prodhimeve vendore dhe e prodhuesve vendorë, në vitin 2005 ishte një tendencë për krijimin e tarifave sezonale dhe për mbrojtjen e produkteve të agrobiznesit. Shtoi se në atë kohë ishte një letër nga administrata e UNMIK-ut që nuk lejonte një gjë të tillë, sepse sipas tyre kjo binte ndesh me CEFT-ën, me nënkomisionet e saj, por edhe me Marrëveshjen për tregtinë e lirë. Ai kërkoi që MTI-ja me të gjithë mekanizmat e vet, me të gjitha kapacitetet, në ato vakume qofshin ligjore ose marrëveshje bilaterale, të intensifikoj përkrahjen e agrobiznesit dhe bujqësisë, të fuqizohet edhe prodhimtaria në përputhje me kartën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesmeve, që është një dokument i njohur në Evropë. Ai përfundoi se, duke e marrë parasysh gjendjen në të cilën janë ekonomia dhe industria kosovare, për Qeverinë dhe për Kosovën, bujqësia dhe agrobiznesi duhet të jenë prioritet.

Edita Tahiri - tha se pasi ka kontradiktë reale ndërmjet aspiratave të integrimi ndërkombëtare dhe çështjes së tarifave doganore: kur pritet të tejkalohet ky problem? Ajo shtoi, besoj se do të ndodhin këto veprime të politikave të brendshme në mënyrë që të bëjmë hapa të mëtutjeshëm për integrimi evropiane, pasi integrimi evropiane janë synime kryesore të Kosovës në këtë fazë kur po punojmë për njohjen globale të vendit si dhe për krijimin e imazhit.

Hydajet Hyseni - tha se në procesin e integrimi evropiane e më të gjera, s' mund të anashkalohet edhe nevoja për integrimi me të ngushta nacionale dhe rajonale, sepse se përjashtojnë njëra-tjetrën. Sa i përket funksionimit institucional tha se është një ngatërrim i prioritetëve të secilit segment shoqëror. Për këtë kam pasur rast të marr pjesë në takimet e Paktit të Stabilitetit, ku kanë qenë edhe përfaqësuesit e Qeverisë. Ai shtoi se i kishte bërë përshtypje një qasje shumë entuziaste, jo sa duhet e përgatitur, e politizuar në procesin e integrimi dhe të segmentëve që janë ekzekutive, sepse Ministria nuk është e ngarkuar ta bëjë politikën e vendit, ajo mund ta bëjë vetëm për fushën për të cilën është përgjegjëse. Sa i përket përvojës sonë me CEFT-ën, mendoj se duhet të analizohet, sepse nuk pavarësohet Kosova as se e ka bërë një marrëveshje të tregtisë së lirë, as pse i ka bërë disa hapa në të ashtuquajturin decentralizim, siç pretendohet të paraqitet. Për këtë do të duhet të shikojmë sa ka pasur ndikim ajo në biznesin tonë. Këtë e them që t'i analizojmë edhe përvojat pozitive, edhe mangësitë e kësaj marrëveshjeje. Integrimi nuk është qëllim më vete, por është në funksion të diçkaje që është më e madhe se sa vendosja e disa kontakteve. Ai konstatoi se prioritetet janë shumë të rëndësishme, por jo në mënyrë naive, jo në mënyrë të politizuar, por të studiuar, të analizuar dhe të koordinuar.

Zylfie Hundozi - kërkoi sqarim se me nënshkrimin e Marrëveshjes për tregti të lirë, a ekziston klauzula për mbrojtjen e produkteve vendore?

Lutfi Zharku - shpjegoi se për mbrojtjen e prodhimeve bujqësore Kosova e ka sistemin më të dobët dhe më të thjeshtë. Tarifa doganore është 10%, për arsye se UNMIK-u nuk lejon vendosjen e barrierave të ndryshme tarifore. Kjo kontradiktë ndërmjet integriteteve dhe tarifave doganore, besoj se do të tejkalohet me bartjen e kompetencave, me ç'rast do të bëhen tarifat doganore sipas politikave ekonomike që i vendos Qeveria e Kosovës. Sa i përket CEFT-ës analizat e para tregojnë se ka rritje të shkëmbimit me vendet e CEFT-ës dhe me vendet e Unionit Evropian.

Ibrahim Krasniqi – tha e kemi një marrëveshje me mbështetjen e USAID-it që prodhimet tona në një sasi të madhe të eksportohen në Shqipëri. Kemi arritur ta rritim eksportin, por duhet ta kemi parasysh edhe anën negative që mund të ketë CEFT-a. Shtoi se politikat e Bashkimit Evropian që imponohen edhe në kuadër të CEFT-ës, nuk mundësojnë që për sektorë të ndryshëm shteti të japë subvencione. Ai njoftoi se me politikat e miratuara në vitet e fundit çështja e subvencioneve shihet si e padëshirueshme.

Hydajet Hyseni - tha s'mund të kontestohet se mënyra më e mirë është t'i bëjmë prodhimet konkurrenca, por shtrohet çështja a është vetëm konkurrenca ajo që po e pengon prodhimin tonë, apo në vendet e tjera kanë forma, lehtësime, subvencione të ndryshme me të cilat stimulohen prodhuesit dhe kështu ata bëhen artificialisht të favorizuar në tregun kosovar. Prandaj e shoh nevojën për harmonizim me ministrinë e tjera, të shikohet ku do të duhej të stimulohej qoftë me ndonjë kredi, qoftë me ndonjë lehtësim. Shtoi se një prodhues që i ka të siguruara farën dhe karburantet, natyrisht do të jetë në kushte më të mira se sa prodhuesi që nuk i ka. Prodhuesi ynë nuk i ka, prandaj është i hendikepuar. Ai konkludoi se duhet ta synojmë konkurrencën, por shtoi se ka nevojë të ndihmohet, stimulohet, siç praktikohet edhe në vendet e tjera.

Sabri Hamiti - tha se duhen programe zhvillimore, sepse në qershor mendohet të mbahet Konferenca e donatorëve dhe me programe bindëse merren para nga BE-ja ose nga shtetet e veçanta, para që shkojnë për këtë sektor. Në këtë drejtim, ta marrim shembull Maqedoninë, që nxjerr prodhime, sepse Bashkimi Evropian ia ka ndarë 60 milionë euro vetëm për zhvillimin e bujqësisë. Ai shtoi se integrimi nuk është vetëm vullnet politik, por edhe zhvillimor.

Edita Tahiri - kërkoi të njoftohen se cilat janë kriteret ndërkombëtare për politikat e subvencioneve në këtë kohë, pasi dihet se janë të kontestueshme dhe për politikat e mbrojtjes së prodhimeve, meqë edhe këto me standardet evropiane nuk janë të preferueshme.

Ibrahim Krasniqi - tha se në parim politikat e Komisionit Evropian dhe politikat në rajon nuk shkojnë në favor të subvencioneve për prodhues të caktuar. Ai njoftoi se në Tiranë është diskutuar ideja që të merren ndihma shtetërore në raste të caktuara. P.sh. me ngritjen e çmimit të bukës ose të produkteve bazike, por as kjo ndihmë nuk lejohet me

politikat evropiane. Ai shtoi se ndihma shtetërore nënkupton intervenim në një rast të caktuar, qoftë fatkeqësi natyrore ose aksidente.

Hydajet Hyseni - tha se tjetër është ndërhyrja në treg dhe tjetër ndikimi i shtetit për stimulimin e prodhimit, që është detyrë prioritare. Pyeti a mund të jetë prodhimi i duhanit konkurrent në Kosovë dhe Qeveria a duhet të ketë një program stimulues për riaktivizimin e prodhimit të duhanit. Shtoi se këta hapa duhet të ndërmerren para se të krijohen situata, në mënyrë që të mos ketë nevojë për intervenim të shtetit me metoda të tejkaluara dhe të palejuara për të ndërhyrë në treg. Propozoi që me politika shtetërore dhe donacione të gjendet mënyra që prodhimi të jetë konkurrent, rentabil dhe të mos ketë ndërhyrje.

Lutfi Zharku - shpjegoi se problemi më i madh në politikën e Bashkimit Evropian është çështja e subvencioneve për prodhimet bujqësore. Shtoi se në momentin kur bëhet një marrëveshje, shkalla e asaj se sa mund të subvencionohet, rregullohet me atë marrëveshje. Unë, personalisht, nuk e përkrah shumë çështjen e subvencioneve.

Zylfije Hundozi – e falënderoi ministrin për bashkëpunim dhe për paraqitjen e politikave dhe të strategjisë së kësaj Ministrie lidhur me integrimet evropiane.

4. Miratimi i planit të punës

Plani i punës u miratua pa vërejtje.

5. Të ndryshme

Edita Tahiri - Propozoi që për krijimin e kushteve sa më të mira për punë, në faqen e internetit të Kuvendit të hapet një dritare për Komisionin e Integrimi Evropiane. Shtoi se çdokund në botë secili deputet ka zyrë, kurse te ne nuk kemi zyrë as për Komisionin. Në mënyrë që të jemi sa më produktivë dhe në rrjedha, do të ishte mirë të bëhet digjitalizimi i materialit.

Zylfije Hundozi – E përkrahu idenë e Editë Tahirit dhe i njoftoi anëtarët e Komisionit se Kryesia e Kuvendit e ka lejuar një zyrë për Komisionin e Integrimi Evropiane.

Pas diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Të kërkohet hapja dhe mirëmbajtja e faqes së internetit për Komisionin e Integrimi Evropiane në kuadër të faqes së internetit të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtës
Adelina Demolli

Kryetarja e Komisionit
Zylfije Hundozi